



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400-39472 të datës 16.07.2021 të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 500€ (pesqindë euro), sipas kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 1Nr.400-39472 të datës 16.07.2021, për të mbështetur financiarisht në rastin e festës së "Kurban Bajramit" për t'iu dalur në ndihmë familjeve në nevojë me artikuj ushqimor dhe shpërndarjen e dhuratave për fëmijë.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Bashkësisë Islame në nr. 17192000190037882 në NLB Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara të lartëcekura duhet të sjell raportë dhe dëshmi-faturë deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 08.10.2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Bashkësia Islame dega në Lipjani.

1Nr.400-39472
Lipjan, më 16.07.2021

